



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



## DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Drejtoria Komunale e Arsimit, duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 09/2023 për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, bënë këtë

### NJOFTIM

Të nderuar prindër, Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë për **vitin shkollor 2024/25** bëhet prej **15 maj 2024** deri **15 qershor 2024**, në të gjitha shkollat e komunës së Deçanit.

#### I. Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë

1. Fëmija regjistrohet në klasën e parë pasi të ketë mbushur moshën minimale gjashtë (6) vjeç.
2. Regjistrimi i fëmijës në klasën e parë para moshës gjashtë (6) vjeç bëhet vetëm atëherë kur ka një vlerësim dhe rekomandim të një ekipi profesional, të caktuar nga shkolla. Ekipi vlerëson pjekurinë njohëse, sociale, motorike dhe emocionale të fëmijës duke përcaktuar gatishmërinë e fëmijës për të hyrë në klasën e parë. Vendimin përfundimtar e merr drejtori i shkollës.
3. Ekipi profesional përbëhet nga psikologu, pedagogu, mësuesi mbështetës i shkollës, etj.
4. Fëmija me diagnozë mjekësore para regjistrimit referohet tek ekipi komunal për vlerësim pedagogjik në Drejtorinë Komunale për Arsim.

#### II. Dokumentacioni

1. Për regjistrim në klasë të parë, fëmija duhet të ketë certifikatën e lindjes/ekstraktin e lindjes, certifikatën e vaksinimit dhe dëshminë për vendbanim nga bashkësia lokale, e cila nuk është më e vjetër se gjashtë (6) muaj.
2. Dokumentet e prindit/kujdestarit ligjor.
3. Formulari i regjistrimit plotësohet në momentin e regjistrimit pranë institucionit arsimor.
4. Për fëmijët që kanë ndjekur edukimin parafillor, në raste specifike mund të kërkohet edhe një vlerësim përshkrues për fëmijën nga edukatorja.

#### III. Zonimi

Për regjistrim të fëmijës në klasën e parë, drejtorja e shkollës bazohet në sistemin e zonimit të përcaktuar nga komuna.

Për detajet e tjera do të informoheni nga shkollat që janë brenda zonës tuaj.  
Të gjithë fëmijëve u urojmë suksese!

Me respekt,  
Besnik Hulaj, Drejtor i Arsimit



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - DEÇAN MUNICIPALITY	
Nr. i Protokollit	14212
B. Shprehje	07
No. i Dokumentit	07.05.24
DEÇAN, DEÇANE	